



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5165 Prot

Lezhë, më 11 / 5 /2023

VENDIM

Nr. 36, Datë 10 . 05 .2023

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM DHE BASHKISË LEZHË PËR NDËRTIMIN E NJË STACIONI TË RI ZJARRFIKËS NË BASHKINË LEZHË NË KUADËR TË PROJEKTIT “FORCIMI I KAPACITETEVE TE SHERBIMIT SHQIPETAR TE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMI”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë Nr. 72, datë 28.06.2022 për “ Lidhjen e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë për zbatimin e projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, shkresës së Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara Nr. 4607, datë 02.05.2023 të Draft Marrëveshjes së financimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë, për ndërtimin e një stacioni të ri zjarrfikës në Bashkinë Lezhë në kuadër të Projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë për ndërtimin e një stacioni të ri zjarrfikës në Bashkinë Lezhë në kuadër të projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.
2. Ngarkohet për firmosjen e Marrëveshjes së Financimit Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Prot 5165/1

17.05.23

le B



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 389/4 Prot.

Lezhë, më 16.05.2023

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, "ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit të këshillit të Bashkisë Lezhë nr.36, datë 10.05.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim dhe bashkisë Lezhë për ndërtimin e një stacioni të ri zjarrfikës në bashkinë Lezhë në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve të shërbimit shqiptar të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

